



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 nëntor 2017
Nr. ref.:RK1157/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI87/17

Parashtrues

Hilmi Asllani

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të marrë nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, sh. a. nr. 9199, të 4 nëntorit 2015

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Hilmi Asllani nga fshati Stanovc i Ulët (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Afrim Salihu, avokat në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës shprehimisht konteston Vendimin nr. 9199 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të lëshuar nga Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike, sh. a. (në tekstin e mëtejme KEDS), të 4 nëntorit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se është shkelur e drejta e parashtruesit të kërkesës e garantuar me paragrafin 5 të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 i Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 korrik 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 31 korrik 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 4 gusht 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që ta plotësonte formularin e kërkesës dhe të specifikonte se cilin vendim të një autoriteti publik e konteston në Gjykatë.
8. Më 10 gusht 2017, parashtruesi dorëzoi formularin e plotësuar të kërkesës dhe saktësoi se ai e konteston Vendimin nr. 9199 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të lëshuar nga KEDS, të 4 nëntorit 2015.
9. Më 14 gusht, Gjykata dërgoi një kopje të kërkesës në KEDS.
10. Më 24 gusht 2017, KEDS parashtrroi një letër me komente lidhur me pretendimet e parashtruesit të kërkesës.
11. Më 14 nëntor 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Parashtruesi i kërkesës ishte punonjës i KEDS-it (në tekstin e mëtejshmë: punëdhënësi).
13. Më 15 qershor 2015, Prokuroria Themelore në Prishtinë (PP. I. nr. 400/2015) ngriti aktakuzë duke e akuzuar parashtruesin e kërkesës për kryerjen e veprës penale të paraparë në nenin 428 [Marrja e ryshfetit] në lidhje me nenin 31 [Bashkëkryerja] të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshmë: KPRK).
14. Më 4 nëntor 2015, punëdhënësi mori Vendimin nr. 9199 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së parashtruesit të kërkesës (në tekstin e mëtejshmë: Vendimi i KEDS-it).
15. Në vendimin e tij, punëdhënësi deklaroi se *“Punëmarrësi – Hilmi Asllani në bashkëpunim me kolegun e tij [...] janë pajtuar [...] me konsumatorin për të fshehur manipulimin e njehsorit elektrik, me ç’rast si kundërshpërblim e kanë pranuar ofertën nga konsumatori të bërë për një shumë të parave [...], të cilët në flagrancë janë arrestuar [...] nga Zyrtarët Policor të SHPK-së [...]. Nga ky veprim i keq sjelljeve punëmarrësi ka bërë shkelje të rënda të detyrave të punës nga neni 7, paragrafi 7.1, nënparagrafi (f), (g), pika (i) dhe nënparagrafi (h,) të Kodit Disiplinor të KEDS-it. [...] Për këtë keq sjellje – shkeljet nga pika paraprake, të përmendurit i shkëputet kontrata e punës prej datës 23.10.2015”*.
16. Më 10 nëntor 2015, kundër vendimit të punëdhënësit, parashtruesi parashtrroi ankesë pranë organit të shkallës së dytë të punëdhënësit.
17. Më 25 nëntor 2015, punëdhënësi hodhi poshtë ankesën e parashtruesit si të pabazuar. Në këtë vendim, parashtruesi ishte udhëzuar të iniciojë procedurë gjyqësore në gjykatat kompetente kundër vendimit të punëdhënësit.
18. Në bazë të shkresave të lëndës, vërehet se parashtruesi nuk kishte shfrytëzuar mundësinë për të vazhduar me procedurat ligjore pranë gjykatave kompetente.
19. Lidhur me procedurën penale kundër parashtruesit të kërkesës, më 14 shtator 2016, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda (në tekstin e mëtejshmë: Gjykata Themelore), me Aktgjykimin PKR. nr. 334/15 e liroi parashtruesin e kërkesës nga vepra penale pasi që nuk ishte vërtetuar se parashtruesi i kërkesës e kishte kryer veprën penale për të cilën ai ishte akuzuar.
20. Më 2 shkurt 2017, Prokuroria Themelore në Prishtinë (PP.I. nr. 400/2015) parashtrroi ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje të ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit për sanksionin penal.
21. Më 25 prill 2017, Gjykata e Apelit (Aktgjykimi PAKR. nr. 93/17) refuzoi ankesën e Prokurorisë Themelore si të pabazuar dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të *“së drejtës së tij në prezumim të pafajësisë derisa të mos dëshmohet fajësia e tij”* siç parashihet në paragrafin 5 të nenit 31 të Kushtetutës.
23. Në esencë, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“[...] KEDS ka shkelë Kushtetutën e R. Kosovës edhe atë nenin 31 par 5, duke ja ndërprerë marrëdhënien e punës pa u përfunduar fillimisht rasti Penalno -Juridike [...]”*
24. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese të konkludojë se: *“[...]Kushtetuta e Kosovës është shkelur edhe atë neni 31, par 5, sepse KEDS ende pa përfunduar procedura e gjyqimit e ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë arbitrare dhe të ngutshme duke e larguar nga puna dhe duke ja ndërprerë Kontratën e punës, kur ka mundur shumë lehtë ta përmirësoj rastin e krijuar duke e kthyer në punë [parashtruesin e kërkesës], duke ja kompensuar pagat e papaguara dhe duke e anuluar vendimin të cilin e kishte marrë në mënyrë të jashtëligjshëm”,*

Komentet e KEDS-it

25. Më 24 gusht 2017, KEDS parashtrroi komentet e veta lidhur me rastin e parashtruesit dhe ndër të tjera, deklaroi se: *“Një pretendim i tillë i parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës është i pabazë për faktin se përgjegjësia disiplinore dhe përgjegjësia penale janë të ndara dhe në as një rast nuk nënkupton se lirimi nga përgjegjësia penale nënkupton lirimin nga përgjegjësia disiplinore. E drejta disiplinore ka të bëjë me disiplinën e cila i referohet punës dhe sjelljeve të punëtorit në punë apo lidhur me punën. Në rastet kur punëtori bën shkeljen apo cenimin e detyrave të punës dhe sillet në kundërshtim me normat e disiplinës së punës, ai duhet t'i nënshtrohet përgjegjësisë disiplinore. [...]”*
26. Në komentet e tij KEDS gjithashtu deklaroi se: *“Nga kërkesa e datës 28.07.2017 e dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, shihet qartë se nuk ka vendim përfundimtar (vendimi i atakuar nr. 9199 i datës 04. 11. 2015 i KEDS sh a nuk është vendim përfundimtar) që i njëjti vendim do të kontestohet në gjykatë, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas ligjit të aplikueshëm [...]”*

Pranueshmëria e kërkesës

27. Gjykata së pari do të shqyrtojë nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe Rregullore të punës.
28. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.”

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

29. Gjykata, gjithashtu, i referohet nenit 47 [Kërkesat individuale] të Ligjit, i cili përcakton se:

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

30. Përveç kësaj, Gjykata rikujton rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar”

[...]

31. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të lëshuar nga KEDS më 4 nëntor 2015.
32. Megjithatë, Gjykata rikujton që vendimi përfundimtar në rastin e parashtruesit të kërkesës është Vendimi i dytë i punëdhënësit i nxjerrë më 25 nëntor 2015. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se, në vendimin e fundit të lartpërmendur të punëdhënësit të 25 nëntorit 2015, parashtruesi ishte informuar për të drejtën e tij për të filluar procedurën ligjore kundër vendimit të punëdhënësit në gjykatat kompetente.
33. Bazuar në faktet e lartpërmendura, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk e ka shfrytëzuar mundësinë për të vazhduar me procedurat ligjore në gjykatat kompetente.
34. Bazuar në si më sipër, Gjykata konsideron se dështimi i parashtruesit për të shteruar mjetet juridike në dispozicion në gjykatat e rregullta do të kuptohet si heqje dorë nga e drejta për të vazhduar me procedurat në gjykatat e rregullta. Prandaj, parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike që i janë dhënë atij me ligjin e zbatueshëm (shih, *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së, *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendim i 25 nëntorit 1996, rasti i Gjykatës Kushtetuese KIO7/09, *Demë dhe Besnik Kurboqaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 19 majit 2010, paragrafët 28-29).

35. Parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesit t'i kenë shteruar të gjitha mundësitë procedurale në procedurat e rregullta në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës apo, nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore para se të vijnë në Gjykatën Kushtetuese (Shih *mutatis mutandis*, rasti i GJEDNJ-së *Selmouni kundër Francës*, nr. 25803/94, Vendim i 25 nëntorit 1996, shih rastet e Gjykatës Kushtetuese KI120/11, *Ministria e Shëndetësisë*, Aktvendim për papranueshmëri i 4 dhjetorit 2012, par. 32, KI118/15, *Dragiša Stojković*, Aktvendimi për papranueshmëri i 17 majit 2016, par. 34).
36. Duke pasur parasysh rrethanat e rastit dhe faktin që parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion në gjykatat e rregullta, Gjykata nuk e konsideron të nevojshme të vlerësojë nëse vendimi i kontestuar i lëshuar nga KEDS-i bie në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.
37. Prandaj, duke marrë parasysh se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në procedurat pranë gjykatave të rregullta para se të paraqitet në Gjykatën Kushtetuese, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kërkesat e pranueshmërisë të përcaktuara në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafin 7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 nëntor 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi